

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Së shpejti marrëveshje me rrjetin universitar në Londër"/ Rama: Do të hapim 4 universitete, studimet nis in në 2027-2028
ADRESA	https://piranjat.al/politike/se-shpejti-marreveshje-me-rrjetin-universitar-ne-londer-ram-a-do-te-hapi-i103873
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 08:55:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 08:49:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d77bb507e070c3710b9e20d62c3b44111fb96262812522d11f2dcd3e50170012
TEKSTI	de598052d6d2474a67afa2d0e65d9739b2bbd99bc452a085b086a4fa5ae5226e
PAMJA	b7776ec85b3a6a6ee166fa573482645a3c8701a56040d49c2cbbf1fc9f270d79

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2e03e888daffc419372d09e9a8b85c7c48d017411d1cde4c852b865349180679
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	10ab5b8f79eea0a6c9439c21099c504de5d405b01d4b1e67f07490a5465dacd2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2e03e888daffc419372d09e9a8b85c7c48d017411d1cde4c852b865349180679>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [e djegur](#) [Matit, ku bëhet me](#) [dijë se](#) ■ [bllokohet dhe](#) [Unaza](#) [do të rrethojnë](#) [Krye...](#) ■ [Shkodër,](#) [policia në](#) [minuta më parë,](#) [Ngjarja](#) ■ [te bandes](#) [së](#) [policëve](#) [një ndjekje që përfundon](#) ■ [Krugat 130](#) [metra e](#) [mbuluar](#) [Beratit,](#) [denoncojnë](#) [në](#) ■ [dua,](#) [Shq](#) [bas](#)

[POLITIKE](#)

"Së shpejti marrëveshje me rrjetin universitar në Londër"/ Rama: Do të hapim 4 universitete, studimet nisin në 2027-2028

Piranjat Përditësimi i fundit 13 Shtator 2026, 10:49



Kryeministri Edi Rama tha se Shqipëria është drejt një marrëveshjeje me një rrjet universitar në Londër. Duke folur në podcast-in "Flasim", Rama tha se pjesë e marrëveshjes është hapja e një rrjeti universitetesh.

Sipas tij, bëhet fjalë për një universitet mjekësor në Fier, një të përgjithshëm në Vlorë, një për teknologjinë në Korçë dhe një tjetër, sërish i Përgjithshëm, në Tiranë. Rama tha më tej se studimet në dy universitete do të hapen gjatë 2027-2028 dhe në dy të tjerët, 2028-2029.

"Me shumë gjasë, së shpejti, ne do të nënshkruajmë një marrëveshje me një nga rrjetet më të mëdha universitare të botës, i bazuar në Londër dhe pjesë e marrëveshjes është edhe plani i përbashkët për të hapur Universitetin e Mjekësisë në Fier. Universiteti mjekësor i Fierit do të jetë ndërkombëtar, me reputacion ndërkombëtar, me studentë shqiptarë dhe nga e gjithë bota. Ne jemi shumë afër, kemi filluar një proces diskutimesh dhe kemi parë një studim, një draft të fisibilitetit, është fantastik, por presim studim përfundimtar nga ana e tyre.

Është investim shumë i madh që do të bëjmë, ne do të vëmë në dispozicion infrastrukturën, ata do të sjellin pedagogë, por komponent i rëndësishëm do të jetë edhe zgjedhja e pedagogëve shqiptarë që ata synojnë t'i zgjedhin jo vetëm këtu, por edhe në diasporë. Është plan goxha ambicioz. Janë 4 universitete, është universiteti i Fierit, universiteti i Tiranës, është universiteti i Vlorës, i përgjithshëm, më i madhi ndër të 4, ambicia jonë është ta instalojmë në qendër të Vlorës, te Sheshi i Flamurit, universitet ndërkombëtar që të krijojë dinamikë të re.

Një tjetër në Korçë për teknologjinë dhe inteligjencën artificiale dhe tjetri, i Përgjithshëm në Tiranë. Duam ta konkludojmë të gjithën brenda këtij viti dhe duam që të fillojë mësimi në 2 nga 4 universitetet, në sezonin 2027-2028 dhe 2028-2029, të katërt janë në funksion", tha Rama.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 13 Shtator09:56

[Rama 'nuk iu ndahet' pagave të gjyqtarëve: E rritën 2000 euro më shumë se kolegët në Greqi dhe 3 mijë më shumë se në Malin e Zi](#)

Kryeministri Edi Rama ka shprehur sërish kundërshtinë e tij në 'X', në lidhje me pagat e reja që magjistratët mir...

POLITIKE 13 Shtator08:40

["Lëvizje kundër qeverisë Rama"/ Media amerikane jehonë protestës në vend, publikon pamje nga tubimi](#)

Protestat qytetarë në Tiranë të cilat kanë nisur që në fund të muajit maj kundër klasës politike vijnë...

POLITIKE 12 Shtator22:50

[Tubimi i 105/ Protestuesit përballë policëve: Hiqni kapelet, arrestoni Ramën](#)

Vazhdon për më shumë se tre orë protesta qytetare kundër qeverisë në bulevardin Dëshmorët e Kombit në Tiranë...

POLITIKE 12 Shtator22:16

Dita e 105-të e protestës/ Protestuesit rrethojnë godinën e Kryeministrit, bllokohet dhe Unaza

Në ditën e 105-të protestuesit ndryshuan strategjinë. Nuk do marshojnë në rrugët e qytetit por do të rrethojnë Krye...

POLITIKE 12 Shtator22:11

"Rrethoni Kryeministrinë"/ Përsëritet thirrja në protestë, Rama nxjerr policët për të mbrojtur godinën

Po mbahet protesta e 105 kundër qeverisë në Tiranë, ku këtë herë dhe diaspora është në shesh. Është...

POLITIKE 12 Shtator21:15

Oshëtin bulevardin: Arrestoni Ramën. Protestuesi: Të bllokojmë rrugët, të nisim mosbindjen civile

Bulevardi Dëshmorët e Kombit në Tiranë është mbushur përplot me qytetarë sot në ditën e 105, kur në kryeq...

POLITIKE 12 Shtator21:05

"Mos e lejoni kriminelin të na shesë tokat"/ Emigrantja nga Italia mesazh Melonit për Ramën

Një emigrante, që ka ardhur nga Italia për të protestuar në shesh, theksoi se qytetarët shqiptarë nuk duhet ta lejojnë m...

POLITIKE 12 Shtator20:50

"Diaspora nuk ia fal krimet Ramës"/ Protestuesi nga Roma: Nuk do lejojmë hajdutët të bëjnë pazare me shqiptarët

Një nga protestuesit në ditën e 105 deklaroi se diaspora nuk ia fal krimet Ramës që ka bërë kundër popullit shqiptar. A...

POLITIKE 12 Shtator20:14

Bulevardi i mbushur plot/ Protestuesit me pankarta në duar: Shqiptarët e bashkuar, pushteti i tmerruar

Sot në ditën e 105 të protestës, bulevardi Dëshmorët e Kombit është mbushur plot. Kjo, pasi në mbështetje tëe...

POLITIKE 12 Shtator19:54

"Diaspora është me ne"/ Aktivistja Vatnikaj: Këtu vendosim ne, Rama të japë dorëheqjen

Aktivistja Sidorela Vatnikaj, në fjalën e saj në protestën e 105 tha se diaspora e ka bërë protestën e fuqishme sot. Vatnika...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 12 Shtator

EMRI- 2.4 mln euro kokainë në trëndafila/ Kush ...

Personi i arrestuar në Greqi si kreu i grupit të trafikut të kokainës nga Kolumbia përmes trëndafilave është Lulzim Cak...

AKTUALITET 12 Shtator

Si arriti të fitonte lirinë Lulzim Caka në Shqi...

Lulzim Caka është emri i personazhit misterioz të arrestuar nga policia greke si kreu i grupit kriminal shqiptar pas trafikut të 84 kg kokai...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 12 Shtator

"Bëmë takim familjar"-Flet Ziza Pajaziti: Ja si...

Modelja kosovare Ziza Pajaziti, e cila në datat 12 dhe 13 qershor 2025 rezulton të ketë hyrë në ambientet e burgut të sigurisë...


INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratteri për Piranajat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimeve...

video





Reagon Cllevio!






Reagon Cilevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.